

Termet e Referencës

Organizata	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Qëllimi i Angazhimit	Përplimi i raportit mbi arritjet kryesore të HANDIKOS në llogaridhënien sociale dhe pjesëmarrjen e fëmijëve
Data e publikimit	04/10/2021
Data e mbylljes	08/10/2021
Data e vlerësimit të ofertave	11/10/2021
Lloji i konsulencës	Individuale/Kompani
Kohëzgjatja e konsulencës	Tetor - Dhjetor 2021
Raporton tek	Koordinatori/ja i/e projektit
Adresa	Rr. "Nekibe Kelmendi", 10000, Veternik, Prishtinë
Email	handikos@handi-kos.org

HANDIKOS

HANDIKOS, është organizatë jo qeveritare, e themeluar më 1983 me objektivin kryesor për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HANDIKOS aktivisht lobon dhe mbron në nivel lokal dhe qendror të drejtat e personave me aftësi të kufizuara me dhe për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Përgjatë gjithë përvojës së saj, HANDIKOS ka përfaqësuar dhe adresuar nevojat e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara përmes ofrimit të shërbimeve rehabilituese fizikale dhe atyre psiko-sociale, për më tepër përmes ofrimit të pajisjeve ndihmëse për ata në nevojë.

HANDIKOS vazhdon të punoj me dhe për personat me aftësi të kufizuara, duke ngritur kapacitetet e anëtarëve të saj në fusha të ndryshme të cilat shpjen drejt jetesës së pavarur.

HANDIKOS, nga viti 2017 është duke implementuar projektin "Promovimi i parandalimit të dhunës në të gjitha mjediset ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë" në partneritet me Save the Children, zyra në Kosovë dhe me financim të SIDA, me qëllim të ndërtimit të një ambienti më të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Përmirësimi i cilësisë së politikave dhe praktikave të sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe rritja e vetëdijes dhe bashkëveprimit ndër-sektorial ndërmjet komunitetit dhe ofruesve të shërbimeve për të parandaluar dhe përgjigjur rasteve të dhunës në të gjitha mjediset në Kosovë; dhe Promovimi i përgjegjësisë sociale e orientuar tek fëmijët si dhe pjesëmarrja e fëmijëve për përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe adekuate për ta, janë dy objektivat kryesore në kuadër të këtij projekti.

Qëllimi i përgjithshëm i konsulencës

Si organizatë që punon në përkrahje të personave me aftësi të kufizuara, HANDIKOS synon garantimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndër të tjera edhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha mjediset, si një e drejtë themelore. Në kuadër të objektivës së dytë të projektit të lartpërmendur, HANDIKOS synon të inkurajojë zgjidhjen e problemeve lokale, duke fuqizuar bartësit e të drejtave dhe përdoruesit e shërbimeve (fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre) për të ndarë pikëpamjet dhe feedbackun e tyre me ofruesit e shërbimeve përmes përfshirjes së tyre në proceset e llogaridhënies sociale, përkatësisht në procesin e Fletënotimit Komunitar. Gjithashtu, në kuadër të kësaj objektivë HANDIKOS synon të mbështes dhe fuqizoj grupin avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të avokuar lidhur me çështjet që i preokupojnë ata si dhe për të marrë pjesë në mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve.

Për të përmbledhur rezultatet e arritura në fushën e llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve përgjatë 5 viteve të implementimit të këtij projekti, HANDIKOS po kërkon një ekspert/kompani i/e cili/a do jetë përgjegjës/e për përpilimin e një raporti përmbledhës i cili pasqyron impaktin e HANDIKOS në fushën e llogaridhënies sociale dhe pjesëmarrjes së fëmijëve, si dhe ofron rekomandime në qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura, duke përfshirë këtu edhe akterët të cilët kontribuan në arritjen e këtyre rezultateve si dhe në mbrojtjen e fëmijëve në përgjithësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Analizimi i materialeve ekzistuese (Tetor 2021)
- Realizimi i hulumtimit në terren me përfituesit e projektit (ofruesit e shërbimeve, prindërit, fëmijët etj.) (Tetor 2021)
- Përgatitja e raportit me gjetjet kryesore dhe rekomandime (Nëntor 2021)

Kohëzgjatja dhe pritjet

Konsulenca është planifikuar të fillojë më 15 Tetor 2021 deri më 03 Dhjetor 2021 me një angazhim prej pesë (5) ditë pune. Nga eksperti/kompania pritjet që drafti i parë i raportit të dorëzohet jo më larg se data 09 Nëntor 2021, ndërkaq drafti final të jetë i gatshëm më 22 Nëntor 2021.

Pagesa

Pagesa për ekspertin/kompaninë do të bëhet pas përfundimit të përgjegjësisve të kontraktuara.

Kualifikimet dhe eksperiencia

Eksperti/kompania duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në shkencë sociale, juridik apo fushë të ngjashme;
- Përvojë paraprake në shkrimin e raporteve me tematikë të ngjashme;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e të drejtave të fëmijëve, specifikisht njohuri të gjera mbi Konventën për të Drejtat e Fëmijës;
- Njohuri mbi mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna;
- Njohuri mbi mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve;
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin vendor;
- Shkathësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;
- Shkathësi ndërpersonale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit;

Negocimi

HANDIKOS rezervon të drejtën për të negociuar përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjes së ofertuesit.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim;
- Koston financiare të kalkuluar për ditët e angazhimit;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/a jo është i/e përshtatshëm/e dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV);
- Certifikatën mbi gjendjen penale (pas përzgjedhjes)
- Certifikatën e Regjistrimit të biznesit dhe TVSH (pas përzgjedhjes/vetëm për kompani)
- Vërtetimin tatimor nga ATK (pas përzgjedhjes/vetëm për kompani)

Procedurat e aplikimit dhe selektimi

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në handikos@handi-kos.org me subjektin *HK_SACP*, apo fizikisht të vendosura në zarf me mbishkrimin "HK SACP", në zyret e HANDIKOS në Rr. "Nekibe Kelmendi", Veternik, Prishtinë, deri më datë **08.10.2021**.

Eksperti/kompania do të përzgjidhet bazuar në përvojën paraprake relevante me fushën, aftësitë individuale dhe argumentuese për pozitën në fjalë, metodologjinë e propozuar si dhe arsyeshmërinë financiare.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.

HANDIKOS trajton Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve si një dokument me rëndësi të madhe dhe angazhohet për procedura rigoroze për të siguruar që i gjithë personeli dhe programet tona të jenë të sigurta për fëmijët. Si rrjedhojë, të gjithë kandidatët do të jenë subjekt i kontrolleve rigoroze të historisë paraprake.

HANDIKOS është e përkushtuar në promovim të diversitetit. Personat me aftësi të kufizuara; personat e komuniteteve etnike apo religjioze minoritare, si dhe personat me HIV inkurajohen të aplikojnë.